



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka  
National Agency for Protection of Personal Data

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA SHETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE			
DRŽAVNA AGENCIJA ZA ZAŠTITU LIČNIH PODATAKA			
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA			
ZYRA E ARKIVIT-KANCELARUA ARHIVA-ARCHIVE OFFICE			
Njesia Org. Org. Units	01	Nr. Prot. Pr. No.	213
Nr. i faqeve Brog stranic No. pages	02	Diti Datum Date:	13.11.2012
PRISHTINË/A			



Nr. prot. 59/2012  
Datë: 13.11.2012

Në mbështetje të nenit 49 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5.) të Ligjit Nr.03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 70/31 maj 2010) mbikëqyrësi kryesor shtetëror merr këtë:

### V E N D I M

1. Këshillohet Kolegji 'FAMA' të marrë vendim për instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë.
2. Të vendoset njoftimi për instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë.
3. Të rregullohet afati i ruajtjes për regjistrimin e sistemeve të vëzhgimit me kamerë.
4. Kolegji 'FAMA' në afat prej 15 ditësh të njoftojë Agjencinë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimit.

### Arsyetim

Në bazë të nenit 46, 47 dhe 48 (paragrafi 1, 1.4.) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejme LMDHP), më datë 02.11.2012, Agjencia ka realizuar kontrollin sipas detyrës zyrtare në Kolegjin 'FAMA'. Pas kontrollit është përpiluar procesverbali me nr.06/2012, i cili është nënshkruar nga personi përgjegjës dhe të njëjtit i është dorëzuar një kopje.

Në bazë të kontrollit të bërë, në procesverbal është konstatuar kjo gjendje:

Gjatë kontrollit që është bërë në Kolegjin 'FAMA' është konstatuar se është i instaluar sistemi i vëzhgimit me kamerë, nuk është nxjerrë akti i brendshëm (vendimi) për instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë, nuk ka shenjë njoftuese (fletënjoftime) dhe nuk është rregulluar afati i ruajtjes së video-vëzhgimit.

Në nenin 62 (paragrafi 1) thuhet se personat në sektorin publik dhe privat mund të instalojnë sistemet e vëzhgimit me kamerë për vëzhgimin e ndërtesave të tyre, nëse konsiderohet e nevojshme për sigurinë e njerëzve dhe sigurimin e pasurisë. Vëzhgimi

Adresa: Pejton Rr. Pashko Vasa Nr. 4, 10000 Prishtinë – Kosovë

me kamerë, në veçanti, mund të jetë i nevojshëm për të vëzhguar hyrjet e ndërtesave ose aty ku, për shkak të natyrës së punës së tyre, ekziston kërcënim potencial ndaj të punësuarve.

Në nenin 62 (paragrafi 2 dhe 3) të LMDHP thuhet që vendimet e nevojshme merren nga nëpunësi kompetent, drejtori ose ndonjë person tjetër i autorizuar nga sektori publik ose privat. Vendimi duhet të përmbajë arsyet për vendosjen e sistemeve të vëzhgimit me kamerë.

Në nenin 61 (paragrafi 2) parashihet që personat në sektorin publik ose privat që kanë për qëllim të instalojnë sistemet e vëzhgimit me kamerë duhet të vendosin njoftimin për këtë. Njoftimi i tillë duhet të jetë i dukshëm dhe të bëhet publik në mënyrë që t'i mundësojë subjekteve të të dhënave që pa vështirësi të njoftohen me masat, më së voni kur të ketë filluar vëzhgimi me kamerë.

Në nenin 62 (paragrafi 6 ) thuhet se secili kontrollues i të dhënave duhet ta krijojë sistemin e dosjeve për regjistrimin e sistemeve të vëzhgimit me kamerë. Sistemi i dosjeve, veçmas nga regjistrimet (pamjet dhe/ose zëri), përmban datën, vendin, kohën e regjistrimit dhe ku ruhen regjistrimet.

Në (paragrafin 7) po të këtij neni thuhet se regjistrimet nga paragrafi 6 të këtij neni mund të ruhen deri në gjashtë (6) muaj përveç nëse nuk kërkohet ndryshe për qëllime legjitime.

Siç është përshkruar në arsyetimin e këtij vendimi, bazuar në nenin 49 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5.) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbikëqyrësi kryesor shtetëror ka marrë vendimin e paraqitur në dispozitiv.

#### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesë, por mund të hapet konflikt administrativ në gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

**Ruzhdi Jashari**

Mbikëqyrës Kryesor Shtetëror

#### Vendimi i dërgohet:

- Kolegjit 'FAMA'
- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Arkivit të Agjencisë

